



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
KOMITETI I MATURËS SHTETËRORE

Nr. 3378 Prot.

Tiranë, më 14.06. 2021

VENDIM
Nr. 1, datë 14.6.2021

Komiteti i Maturës Shtetërore 2021, i ngritur me urdhrin nr. 325, datë 03.11.2020 “Për ngritjen e Komitetit të Maturës Shtetërore 2021”, diskutoi provimin e matematikës zhvilluar në datën 11.06.2021 për të cilin anëtarët e KOMSh dolën me vendimin për:

- a. Ngritjen e një grupi pune të pavarur, me ekspertë të fushës së matematikës, mësues me përvojë dhe maturan të, për të analizuar në detaje dhe vlerësuar me shumë vëmendje çdo pyetje në test, përputhshmërinë me programin, saktësinë shkencore dhe nivelin e vështirësisë.
- b. Për të marrë në konsideratë plotësimin e kërkesës së maturanëve për uljen e kufirit minimal të pikëve për çdo notë, sipas rekomandimeve të grupit të punës nisur kjo nga shqetësimet e paraqitura, të maturanëve, mësuesve dhe prindërve, duke marrë parasysh situatën e një viti jo normal e të vështirë prej pandemisë.
- c. KOMSh dhe strukturat vartëse të MASR(DPAP/DRAP, ASCAP, QSHA) të përgatisin një analize të thellë, me qëllim identifikimin e të gjitha problematikave të mundshme dhe rishikimin e plotë të të gjithë procesit të maturës, akteve rregullatore për këtë proces dhe administrimin e tij.